Kronikë

# Plagosja e dyfishtë në Malësi të Madhe, dëshmia e autorit: Më rrahën nipin, mendova se kishin armë me vete dhe do më vrisnin

*Lul Rakaj, autori i plagosjes së dyfishtë në Malësi të Madhe, në dëshminë e tij ka deklaruar se Besmir Çofi dhe Avenir Hasanaj i kishin rrahur nipin para disa ditësh nipin 13 vjeç.*

Autori i plagosjes Lul Rakaj

Redaksia
16 Shtator, 11:02 | **Përditesimi: 16 Shtator, 11:16**

Share

**MALËSI E MADHE**- Lul Rakaj, autori i plagosjes së dyfishtë në Malësi të Madhe, në dëshminë e tij ka deklaruar se Besmir Çofi dhe Avenir Hasanaj i kishin rrahur nipin para disa ditësh nipin 13 vjeç. Rakaj thotë se i ka qëlluar, pasi ka dyshuar se njëri prej tyre kishte armë me vete.

> *"Pak ditë më parë dy personat që kam plagosur kanë goditur nipin tim duke e rrahur, vetëm 13 vjeç. Di që më kanë goditur nipin i cili më tregoi për ngjarjen e ndodhur.*
>
> *Unë shkova për të folur me ta dhe aty nisi debati. Dyshova se njëri prej tyre kishte armë zjarri ndaj duke menduar se mund të më vrisnin qëllova ndaj tyre", ka dëshmuar Rakaj në Policinë e Shkodrës.*

LEXO EDHE:
**Rënia e nivelit të ujit në Koman, turistët detyrohen të notojnë për në lumin e Shalës! Guida turistike: KESH të hapë portat e HEC-it**

Plagosja ndodhi një ditë më parë, 15 shtator 2024, ndërsa Besmir Çofi dhe Avenir Hasanaj po hynin në një lokal në fshatin Vrakë në Malësi të Madhe rreth orës 09:45 të mëngjesit. Pranë tyre u afrua Lul Rakaj dhe fillimisht mes të treve pati debat, ndërsa vetëm pak çaste më vonë, Rakaj ***nxori armën dhe i qëlloi***, duke i lënë të plagosur.

Pas të shtënave, Lul Rakaj, u largua me shpejtësi bashkë me armën e krimit, duke tentuar për disa orë t'i fshihet policisë. Pas 3 orësh kërkime, RENEA e konstatoi në afërsi të ballkonit të Tamarës, e rrethoi dhe i bëri thirrje të dorëzohej.

Lul Rakaj iu përgjigj thirrjes për dorëzim, por disa herë tentoi të dilte nga rrethimi. Rakaj është personazh i njohur për drejtësinë. 13 vjet më parë ai vrau për hakmarrje në Hot të Malësisë së Madhe Kolë Mushkun, pasi më herët i kishte vrarë të atin.

Sl.E./Shqiptarja.com

**TAG:** Avenir Hasanaj | Besmir Çofi | Lul Rakaj | malesi e madhe | Shkodër

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A ka pasur sukses 'Tempulli' në kapjen e shpërndarësve të drogave në shkolla?**

Po | Jo | Nuk e di

## Lajme të tjera

**Prishja e pazareve të drogës, dy të plagosur në Malësi të Madhe! Arrestohet autori, para 13 vitesh vrau për të marrë hakun e të atit (EMRAT)**
15 Shtator, 10:04

**Komedia 'Krimi është i imi' premierë në Shkodër! Batuta e aktorit Besnik Çinari shkakton të qeshura edhe jashtë shfaqjes**
Ergys Kavaja
14 Shtator, 15:32

**Rendi dhe siguria/ Drejtori i policisë Sokol Bizhga shkon në Shkodër, mbledh drejtorët mes tyre dhe Edmond Sulaj**
Ergys Kavaja
14 Shtator, 14:59

**Shkodër/ Tentoi të kalonte në mënyrë të paligjshme 4 afganë për në Mal të Zi, në pranga 28-vjeçari**
14 Shtator, 14:01

**Reshje të dendura shiu në të gjithë vendin! Si paraqitet situata në akset rrugore të Veriut**
14 Shtator, 12:54

**Malësi e Madhe/ Tentoi t'i vidhte bagëti nën kërcënimin e armës, arrestohet 27-vjeçari**
14 Shtator, 09:10

**E rëndë në Shkodër! U qëllua me grushte një javë më parë, ndërron jetë në spital 52-vjeçari**
13 Shtator, 11:57

**Shkodër/ Operacioni 'Tempulli', pronari i lokalit kapet me kokainë, peshore dhe para! Policia arreston 44-vjeçarin**
13 Shtator, 10:01

**Moti i keq/ Era e fortë 'shkul' pemët në Shkodër, dëmtohet një makinë (FOTO+VIDEO)**
13 Shtator, 08:39

**Nusja bën për spital vjehrrën në Shkodër! 82-vjeçarja: Më goditi me shkop, më mbuloi gjaku! Djali e mbajti të fshehtë dhunën në familje**
Ergys Kavaja
12 Shtator, 13:32

**Aksident në Shkodër, zjarrfikësja del nga rruga, plagosen dy punonjësit**
11 Shtator, 20:17

**Fushë Arrëz/ Mjeti humb kontrollin dhe del nga rruga, humb jetën shoferi**
11 Shtator, 08:20



© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje